

UDHËZIM
Nr. 19, datë 2.8.2023

MBI VENDOSJEN E RREGULLAVE SPECIFIKE PËR KONTROLLIN ZYRTAR TË
TRIKINELËS NË MISH¹

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të neneve 23 dhe 38 të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Përcaktimin e rregullave për monitorimin e rregullt të derrave shtëpiakë, derrave të egër, njëthundrakëve, si një mjet i rëndësishëm për të vlerësuar ndryshimet në përhapjen e sëmundjes së trikinelës.

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Përkufizime

Për qëllim të këtij udhëzimi të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1. “Trikinela” është çdo nematod që u përket specieve të gjinisë trikinela.
2. “Kushte strehimi të kontrolluara” është një lloj blegtorie ku derrat mbahen gjatë gjithë kohës në kushte të kontrolluara nga operatori i biznesit ushqimor, në lidhje me ushqimin dhe strehimin.
3. “Kompartiment (zonë blegtorale)” është një grup fermash në të cilat zbatohen kushtet e kontrolluara të strehimit. Të gjitha fermat që aplikojnë kushte strehimi të kontrolluara, mund të konsiderohen si kompartimente (zona blegtorale).
4. “Autoritet kompetente”, siç përcaktohet në germën “nj” dhe “o” në pjesën e përgjithshme të udhëzimit nr. 17, datë 24.9.2021, “Për kërkesat specifike të higjienës për mishin dhe produktet e mishit, duke përfshirë produktet e mishit, mishin e grirë dhe mishin e ndarë në mënyrë mekanike”.

KAPITULLI II
DETYRIMET E AUTORITETEVE KOMPETENTE DHE TË OPERATORËVE TË
BIZNESIT USHQIMOR

Neni 2
Marrja e mostrave të karkasave

1. Të merren mostra nga karkasat e derrave shtëpiakë në thertore, si pjesë e ekzaminimit postmortem, si më poshtë:
 - a) të ekzaminohen për trikinelën të gjitha karkasat e dosave dhe të derrave të mbarështimit ose të paktën 10% e karkasave të kafshëve të dërguara për therje çdo vit nga secila fermë, e cila njihet zyrtarisht se zbaton kushte strehimi të kontrolluara;

¹ Ky udhëzim është përafruar pjesërisht me Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 2015/1375, të datës 10 gusht 2015, “Për vendosjen e rregullave specifike për kontrollet zyrtare për trikinelën në mish”.

b) të ekzaminohen sistematikisht për trikinelën të gjitha karkasat nga fermat të cilat nuk njihen zyrtarisht se zbatojnë kushte strehimi të kontrolluara.

Një mostër të merret nga çdo karkasë dhe mostra të ekzaminohet për trikinelë, në një laborator të përcaktuar për analizimin e mostrave të marra, në kuadër të kontrolleve zyrtare, duke përdorur një nga metodat e mëposhtme të zbulimit:

a) metodën referencë të zbulimit, të përcaktuar në kapitullin 1, të shtojcës 1; ose

b) një metodë ekuivalente zbulimi, e përcaktuar në kapitullin 2, të shtojcës 2.

2. Nga karkasat e njëthundrakëve, derrave të egër dhe specieve të tjera të kafshëve të mbarështuara dhe të egra, të ndjeshme ndaj infestimit me trikinelë, të merren mostra në mënyrë sistematike në thertore ose në stabilimente për trajtimin e kafshëve të gjahut, si pjesë e ekzaminimit postmortem.

Nga secila karkasë do të merret një mostër dhe mostra do të ekzaminohet në përputhje me shtojcat 1 dhe 3 në një laborator të përcaktuar nga autoriteti kompetent.

3. Në pritje të rezultateve të ekzaminimit të trikinelës dhe me kusht që të garantohet gjurmueshmëria e plotë nga operatori i biznesit ushqimor, karkasat e derrave shtëpiakë dhe të njëthundrakëve mund të priten në një maksimum prej gjashtë pjesësh, në një thertore ose në një stabiliment prerjeje në të njëjtën ndërtesë.

Neni 3 Përfundime

1. Duke përfunduar nenin 2(1), mishi i derrave shtëpiakë, që i është nënshtruar një trajtimi me ngrirje, në përputhje me shtojcën 2, nën mbikëqyrjen e autoritetit kompetent përfundohet nga ekzaminimi për trikinelë.

2. Duke përfunduar nenin 2(1), karkasat dhe mishi i gicave të pashkëputur nga gjiri, të moshës më të vogël se pesë javë të përfundohen nga ekzaminimi për trikinelë.

3. Duke përfunduar nenin 2(1), karkasat dhe mishi i derrat shtëpiak mund të përfundohen nga ekzaminimi për trikinelë, kur kafshët vijnë nga një fermë ose një kompartiment (zonë blegtorale) që njihet zyrtarisht se zbaton kushte strehimi të kontrolluara, në përputhje me shtojcën 4, në qoftë se:

a) asnjë infestim autokton nga trikinela në derrat shtëpiakë të mbajtur në ferma, që njihen zyrtarisht se zbatojnë kushte strehimi të kontrolluara nuk është zbuluar në tri vitet e fundit, kohë gjatë së cilës janë kryer testime të vazhdueshme në përputhje me nenin 2; ose

b) të dhënat mbi historikun e testimeve të kryera në mënyrë të vazhdueshme në popullatën e derrave të therur, të sigurojnë të paktën 95% besueshmëri që prevalenca e trikinelës nuk e kalon një për një milion në këtë popullatë.

4. Me përfundim të nenit 2(3) dhe pas miratimit nga autoriteti kompetent:

a) karkasat mund të priten në një stabiliment prerje që është pjesë e thertores (ngjitur) ose që është e ndarë nga thertorja, me kusht që:

i. procedura të aprovohet nga autoriteti kompetent;

ii. karkasa ose pjesët e saj nuk kanë si destinacion më shumë se një stabiliment prerjeje;

iii. në rast të një rezultati pozitiv, të gjitha pjesët shpallen të papërshtatshme për konsum njerëzor;

b) karkasat që rrjedhin nga derrat shtëpiakë mund të priten në më shumë pjesë në një stabiliment prerjeje në të njëjtën ndërtesë ose ngjitur me thertoren, me kusht që:

i. procedura të aprovohet nga autoriteti kompetent;

ii. prerja ose heqja e kockave kryhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara në kreun 2, “Mbi kërkesat specifike të higjienës për operatorin e biznesit ushqimor, të udhëzimit nr. 17, datë 24.9.2021, “Për kërkesat specifike të higjienës për mishin dhe produktet e mishit, duke përfshirë

produktet e mishit, mishin e grirë dhe mishin e ndarë në mënyrë mekanike”, përpara se të arrihet temperatura e përmendur sipas këtij udhëzimi;

iii. në rast rezultati pozitiv të gjitha pjesët shpallen të papërshtatshme për konsum njerëzor.

Neni 4

Ekzaminimi i trikinelës dhe aplikimi i vulës shëndetësore

1. Karkasat e përmendura në nenin 2 ose pjesë të tyre, me përjashtim të atyre të përmendura në nenin 3(4), nuk duhet të largohen nga ndërtesat përpara se rezultatet e ekzaminimit për trikinelën të rezultojnë negative.

Në mënyrë të ngjashme, pjesët e tjera të një kafshe të destinuara për konsum nga njerëzit ose kafshët, të cilat përmbajnë inde të muskujve të strijuar nuk duhet të largohen nga ndërtesat përpara se rezultatet e ekzaminimit për trikinelën të rezultojnë negative.

2. Mbetjet e kafshëve dhe nënproduktet shtazore që nuk janë të destinuara për konsum njerëzor dhe që nuk përmbajnë muskuj të strijuar mund të largohen nga ndërtesat përpara se të jenë të disponueshme rezultatet e ekzaminimit të trikinelës.

Megjithatë, veterineri zyrtar i thertores mund të kërkojë që të kryhet një ekzaminim për trikinelën ose një trajtim paraprak i nënprodukteve shtazore jo për konsum njerëzor përpara se t’i lejojë ato të largohen nga ndërtesat.

3. Kur ekziston dhe zbatohet një procedurë në thertore, që siguron se asnjë pjesë e karkasave të ekzaminuara nuk largohet nga ndërtesat derisa rezultati i ekzaminimit për trikinelën të rezultojë negativ dhe procedura të aprovohet zyrtarisht nga veterineri zyrtar ose kur zbatohet përjashtimi i parashikuar në nenin 3(4), mund të aplikohet vula shëndetësore përpara se rezultatet e ekzaminimit të trikinelës të jenë të disponueshme.

Neni 5

Trajnimi

Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) të sigurojë që i gjithë personeli i përfshirë në ekzaminimin e mostrave për zbulimin e trikinelës të trajnohen në mënyrë të përshtatshme dhe të marrin pjesë, në:

- a) një program kontrolli të cilësisë së testeve të përdorura për zbulimin e trikinelës; dhe
- b) një vlerësim të rregullt të testimit, procedurave të regjistrimit dhe të analizimit të përdorura në laborator.

Neni 6

Metodat e zbulimit

1. Metodat e zbulimit të përcaktuara në kapitujt 1 dhe 2, të shtojcës 1, të përdoren për ekzaminimin e mostrave të përmendura në nenin 2, kur ka arsye për të dyshuar për infestimin me trikinelë.

2. Të gjitha mostrat pozitive do t’i dërgohen Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) ose laboratorit të referencës së BE-së për përcaktimin e llojit të trikinelës së përfshirë.

Neni 7

Planet e kontigjencës

Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB), Autoritetin Kombëtar të Ushqimit (AKU) dhe Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) do të hartojë një plan kontigjence, që përshkruan të gjitha veprimet që duhet të ndërmerren, kur mostrat e përmendura në nenin 2 rezultojnë pozitive për trikinelë. Ky plan do të përfshijë detaje që mbulojnë:

- a) gjurmueshmërinë e karkasave të infestuar, si dhe të pjesëve të tyre që përmbajnë inde muskulore;
- b) masat për trajtimin e karkasave të infestuar, si dhe pjesëve të tyre;
- c) hetimi i burimit të infestimit, si dhe të çdo përhapjeje midis kafshëve të egra;
- ç) çdo masë që duhet marrë në nivel të shitjes me pakicë ose te konsumatorët;
- d) masat që duhen marrë kur karkasat e infestuar nuk mund të identifikohen në thertore;
- dh) përcaktimi i llojit të trikinelës të përfshirë në infestim.

Neni 8

Njohja zyrtare e fermave që aplikojnë kushte strehimi të kontrolluara

Për qëllimet e këtij udhëzimi, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB) mund të njohë zyrtarisht një fermë ose një kompartiment (zonë blegtorale) që aplikon kushte strehimi të kontrolluara, kur është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në shtojcën 4.

Neni 9

Detyrimi i operatorëve të biznesit ushqimor për të informuar

Operatorët e biznesit ushqimor të fermave që njihen zyrtarisht që aplikojnë kushte strehimi të kontrolluara të informojnë Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo kërkesë të përcaktuar në aneksin 4, e cila nuk përmbushet më, ose për çdo ndryshim tjetër që mund të ndikojë në statusin e trikinelës së këtyre fermave.

Neni 10

Auditimet ose kontrollet e fermave që njihen zyrtarisht se zbatojnë kushte strehimi të kontrolluara

Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të sigurojë që auditimet ose kontrollet të kryhen periodikisht për fermat që njihen zyrtarisht se zbatojnë kushte strehimi të kontrolluara.

Frekuenca e auditimeve ose e kontrolleve të bazohet në risk, duke marrë parasysh historinë e sëmundjes dhe prevalencën, gjetjet e mëparshme, zonën gjeografike, kafshët e egra lokale të prekshme (ndjeshme), praktikat e blegtorisë, mbikëqyrjen veterinare dhe pajtueshmërinë e fermerëve me kërkesat.

Veterineri zyrtar i thertores të verifikojë që derrat shtëpiakë që vijnë nga këto ferma janë ekzaminuar në përputhje me nenin 2(1).

Neni 11

Programet e monitorimit

Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të zbatojë një program monitorimi që mbulon popullatën e derrave shtëpiakë që vijnë nga një fermë ose nga një kompartment i njohur zyrtarisht se zbaton kushte strehimi të kontrolluara, me qëllim që të verifikojë që trikinela mungon në këtë popullatë.

Frekuenca e testimit, numri i kafshëve që do të testohen dhe plani i marrjes së mostrave të përcaktohen në programin e monitorimit. Për këtë qëllim, mostrat e mishit të mblidhen dhe të ekzaminohen për praninë e parazitëve të trikinelës, në përputhje me kapitujt 1 ose 2, të shtojcës 1.

Programi i monitorimit mund të përfshijë metodat serologjike si një mjet shtesë derisa një test i përshtatshëm të validohet nga ISUV-ja.

Neni 12

Tërheqja e njohjes zyrtare të fermave që zbatojnë kushte strehimi të kontrolluara

1. Kur rezultatet e auditimeve ose të kontroleve të kryera në përputhje me nenin 10 tregojnë se kërkesat e shtojcës 4 nuk përmbushen më, AKVMB-ja tërheq njohjen zyrtare të fermës pa vonesë.

2. Kur derrat shtëpiakë të një ferme, të njohur zyrtarisht se zbaton kushte strehimi të kontrolluara, rezultojnë pozitive për trikinelën, AKVMB-ja pa vonesë duhet të:

- a) tërheqë njohjen zyrtare të fermës;
- b) ekzaminojë të gjithë derrat shtëpiakë të kësaj ferme në kohën e therjes;
- c) gjurmojë dhe të testojë të gjitha kafshët e mbarështimit që kanë mbërritur në fermë dhe për aq kohë sa është e mundur, të gjitha ato që janë larguar nga ferma të paktën gjashtë muaj përpara se të rezultonte pozitive; për këtë qëllim, mostrat e mishit do të mblidhen dhe do të ekzaminohen për praninë e parazitëve të trikinelës, duke përdorur metodat e zbulimit të përcaktuara në kapitujt 1 dhe 2, të shtojcës 1;
- ç) hetojë, kur është e nevojshme dhe për aq kohë sa është e mundur, përhapjen e infestimit të parazitëve, për shkak të shpërndarjes së mishit nga derrat shtëpiakë të therur në periudhën që paraprin gjetjet (rezultatet) pozitive;
- d) fillojë, kur është e nevojshme, një hetim epidemiologjik për të sqaruar shkakun e infestimit;
- dh) marrë masat e duhura kur ndonjë karkasë e infestuar nuk mund të identifikohet në thertore, duke përfshirë:
 - i. rritjen e madhësisë për çdo mostër mishi, të mbledhur për testimin e karkasave të dyshuara; ose
 - ii. daklarimin e karkasave të papërshtatshme për konsum njerëzor;
 - iii. marrjen e masave të duhura për asgjësimin e karkasave të dyshuara ose të pjesëve të tyre dhe të atyre që rezultojnë pozitive.

3. Pas tërheqjes së njohjes zyrtare, fermat mund të njihen sërish zyrtarisht, pasi të jenë zgjidhur problemet e identikuara dhe kërkesat e përcaktuara në aneksin 4, të jenë përmbushur në mënyrë të kënaqshme për autoritetin kompetent.

4. Nëse inspektimi ka identifikuar mungesë të përputhshmërisë me nenin 9 ose testim pozitiv në një fermë të një kompartmenti, ferma në fjalë duhet të hiqet nga kompartmenti derisa të rivendoset përputhshmëria.

KAPITULLI III IMPORTET

Neni 13

Kërkesat shëndetësore për importin

1. Mishi që përmban muskuj të strijuar nga speciet e kafshëve që mund të jenë mbartës të trikinelës, importohen në Shqipëri vetëm në qoftë se përpara eksportit është kryer ekzaminimi për trikinelën, në përputhje me kushtet ekuivalente të përcaktuara në nenet 2 ose 3 të këtij udhëzimi, për vendin ku kafshët janë therur.

2. Vetëm vendet e treta të renditura në shtojcën 5 mund të zbatojnë përjashtimet e parashikuara në nenin 3, pikat 2 dhe 3, pasi të kenë informuar Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për zbatimin e këtyre përjashtimeve.

KAPITULLI IV DISPOZITAT SHFUQIZUESE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 14 **Shfuqizimi**

Udhëzimi nr. 9, datë 10.10.2016, “Për kontrollin zyrtar të trikinelës”, shfuqizohet.

Neni 15 **Hyrja në fuqi**

Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

SHTOJCA I METODAT E ZBULIMIT

KAPITULLI I METODA REFERENCË E ZBULIMIT

Metoda referencë e zbulimit për ekzaminimin e mostrave për trikinelë është ISO 18743:2015.

KAPITULLI II METODAT E KUIVALENTE

A. Metoda e tretjes së mostrës së bashkuar mekanikisht/teknika e sedimentimit

1. Pajisje dhe reagentë:

- Thikë ose gërshërë për prerjen e kampioneve;
- Tabaka të ndara me 50 katrorë, secili prej të cilëve mund të mbajë mostra prej afërsisht 2 g mish ose mjete të tjera, që japin garanci ekuivalente për gjurmueshmërinë e mostrave;
- Grirëse mishi ose blender elektrik;
- Një model termo-blender Stomacher 3 500;

- d) Qese plastike të përshtatshme për blenderin laboratorik *Stomacher*;
- dh) Hinka konike ndarëse, me kapacitet 2 litra, mundësisht të pajisura me prizë sigurie tefloni;
- e) Mbajtëse, unaza dhe kapëse;
- ë) Sitë, madhësia e rrjetës 180 mikronë, diametri i jashtëm 11 cm, me rrjetë inoksi ose rrjetë bronzi;
- f) Hinka, me diametër të brendshëm jo më pak se 12 cm, për të mbështetur sitat;
- g) Cilindra matëse qelqi 100 ml;
- gj) Një termometër i saktë në 0,5°C brenda intervalit 20°C deri në 70°C;
- h) Stirrer magnetic;
- i) Rele që ndizet dhe fiket në intervale prej një minute;
- j) Një trikinoskop me një tavolinë horizontale ose një stereo-mikroskop, me një burim drite të transmetuar nën fazë me intensitet të rregullueshëm;
- k) Pjata Petri me diametër afërsisht 90 mm, të ndara me katrorë afërsisht 1 cm, ose pajisje ekuivalente për numërimin e larvave, si në pikën 6.14 të ISO 18743:2015;
- l) acid klorhidrik 17,5 %;
- ll) pepsina me fuqinë e mëposhtme:
- nëse është pluhur ose e grimtuar: 1:10 000 NF (Formulari Kombëtar i SHBA-së), që korrespondon me 1:12 500 BP (Farmakopeja Britanike) dhe me 2 000 FIP (Federata Internacionale e Farmacisë); ose
 - nëse është e lëngshme: pepsinë e lëngshme e stabilizuar me minimumi 660 njësi të Farmakopesë Evropiane/ml.
- Aktivitete të tjera të pepsinës mund të përdoren, me kusht që aktiviteti përfundimtar në lëngun tretës të jetë i barabartë me aktivitetin e 10 g prej 1:10 000 NF, siç përcaktohet në pikën 5.3 të ISO 18743:2015.
- m) Një numër koshash prej 10 litrash që do të përdoren për dekontaminimin e pajisjeve, p.sh. me formol, dhe për lëngun tretës të mbetur nga mostrat që kanë rezultuar pozitive.
- n) Peshore e kalibruar, për peshimin e mostrave dhe/ose pepsinës (saktësia $\pm 0,1$ g).
2. *Mbledhja e kampioneve dhe sasia për t'u tretur*
- Siç përcaktohet në pikën 4.2 të ISO 18743:2015 (shih, gjithashtu, shtojcat A dhe B të tij për detaje të mëtejshme).
3. *Procedura*
- I. *Grirja*
- Grirja e mostrave të mishit paraprakisht në një grirëse mishi do të përmirësojë cilësinë e tretjes. Nëse përdoret një blender elektrik, blenderi duhet të vihet në punë tre deri në katër herë për afërsisht për një sekondë për çdo herë.
- II. *Procedura e tretjes*
- Kjo procedurë mund të përfshijë bashkimin e plotë (100 g mostra në të njëjtën kohë) ose bashkimet më pak se 100 g.
- a) Bashkimet e plota (100 mostra në të njëjtën kohë):
- i. blenderi laboratorik *Stomacher* 3 500 është i pajisur me një qese plastike të dyfishtë dhe kontrolli i temperaturës është vendosur në 40 deri në 41°C;
 - ii. një litër e gjysmë ujë i parangrohur në 40 deri në 41°C derdhet në qesen e brendshme plastike;
 - iii. 25 ml acid klorhidrik 17,5 % i shtohet ujit në *Stomacher*;
 - iv. shtohen 100 mostra me peshë afërsisht 1 g secila (në 25 deri në 30°C) të marra nga çdo mostër individuale në përputhje me pikën 2;
 - v. në fund shtohen 6 g pepsinë ose 18 ml pepsinë të lëngshme. Kjo radhë duhet të ndiqet rreptësisht për të shmangur dekompozimin e pepsinës;

- vi. *Stomacher*-i më pas lihet të përziejë përmbajtjen e qeses për 25 minuta;
- vii. qesja plastike hiqet nga *Stomacher* dhe lëngu i tretjes filtrohet përmes sitës në një gotë prej 3 litrash;
- viii. qesja plastike lahet me afërsisht 100 ml ujë, e cila më pas përdoret për të shpëlarë sitën dhe në fund i shtohet filtratit në gotë;
- ix. deri në 15 mostra individuale mund të shtohen në një grup prej 100 mostrash dhe të ekzaminohen së bashku me këto mostra.
- b) Bashkime më të vogla (më pak se 100 mostra):
- i. blenderi laboratorik *Stomacher 3 500* është i pajisur me një qese plastike të dyfishtë dhe kontrolli i temperaturës është vendosur në 40 deri në 41°C;
- ii. një lëng tretës përgatitet duke përzier rreth një litër e gjysmë ujë dhe 25 ml acid klorhidrik 17,5%. Shtohen 6 g pepsinë dhe përziehet e gjitha në një temperaturë prej 40 deri në 41°C. Kjo radhë duhet të ndiqet rreptësisht për të shmangur dekompozimin e pepsinës;
- iii. nga lëngu i tretjes, matet një vëllim që korrespondon me 15 ml për gram mostër (p.sh. për 30 mostra vëllimi i kërkuar është $30 \times 15 \text{ ml} = 450 \text{ ml}$) dhe transferohet në pjesën e brendshme të dy qeseve plastike, së bashku me mostrat e mishit, me peshë afërsisht 1 g (në 25 deri në 30°C) të marra nga çdo mostër individuale në përputhje me pikën 2.
- iv. uji në një temperaturë prej afërsisht 41°C derdhet në qesen e jashtme për të krijuar një vëllim të përgjithshëm prej një litri e gjysmë në dy qeset. *Stomacher*-i më pas lihet të përziejë përmbajtjen e qeses për 25 minuta;
- v. qesja plastike hiqet nga *Stomacher* dhe lëngu i tretjes filtrohet përmes sitës në një gotë 3 prej litrash;
- vi. qesja plastike lahet me afërsisht 100 ml ujë (në 25 deri në 30°C), i cili më pas përdoret për të shpëlarë sitën dhe në fund i shtohet filtratit në gotë.

III. Zbulimi i larvave me sedimentim

- Akulli (300 deri në 400 g copa akulli, akull i shtypur ose akull i grimcuar) shtohet në lëngun e tretjes për të rritur vëllimin e tij në rreth 2 litra. Më pas lëngu i tretjes përziehet derisa akulli të shkrirë. Në rastin e bashkimeve më të vogla (shih seksionin II (b)), sasia e akullit duhet të reduktohet në mënyrë korresponduese.
- Lëngu tretës i ftohur transferohet në një hinkë ndarëse 2 litra, të pajisur me një *stirrer magnetic* në një fiksues shtesë.
- Sedimentimi lejohet të vazhdojë për 30 minuta, kohë gjatë së cilës hinka e sedimentimit vibrohet me ndërprerje, p.sh. 1 minutë vibrim pasohet nga 1 minutë pushim.
- Pas 30 minutash, 60 ml mostër e sedimentit futet shpejt në një cilindër matës 100 ml (hinka shpëlahet me detergjent pas përdorimit).
- Mostra 60 ml lihet të qëndrojë për të paktën 10 minuta, pas kësaj kohe tërhiqet me thithje supernatanti, për të lënë një vëllim prej 15 ml, që të ekzaminohet për praninë e larvave.
- Për thithje, mund të përdoret një shiringë e disponueshme, e pajisur me një tub plastik. Gjatësia e tubit duhet të jetë e tillë që 15 ml të mbetet në cilindrin matës, kur dorezat e shiringës mbështeten tek buzët e cilindrit.
- Pjesa e mbetur prej 15 ml hidhet në një pjatë Petri ose pajisje ekuivalente për numërimin e larvave dhe ekzaminohet duke përdorur një trikinoskop ose stereo-mikroskop.
- Cilindri matës lahet me 5 deri në 10 ml ujë rubineti dhe shpëlarja i shtohet mostrës.
- Tretësirat duhet të ekzaminohen sapo të jenë gati. Në asnjë rrethanë nuk mund të shtyhet ekzaminimi për ditën e nesërme.

Kur tretësirat janë të paqarta, ato duhet të qartësohen si më poshtë:

- mostra përfundimtare prej 60 ml hidhet në një cilindër matës dhe lihet të qëndrojë për 10 minuta; më pas hiqet me thithje 45 ml lëng sup ernatanti dhe 15 ml e mbetura shtohen në 45 ml me ujë rubineti;

- pas një periudhe qëndrimi të mëtejshme prej 10 minutash, 30 ml lëng supernatanti hiqet me thithje dhe 15 ml e mbetura hidhen në një pjatë Petri ose në pajisje ekuivalente për numërimin e larvave dhe ekzaminohen duke përdorur një trikinoskop ose stereo-mikroskop.

- cilindri matës lahet me 10 ml ujë rubineti dhe ky ujë larës i shtohet mostrës në pjatën Petri ose pajisjes ekuivalente për numërimin e larvave dhe ekzaminohet me anë të trikinoskopit ose stereo-mikroskopit.

IV. Rezultate pozitive ose të dyshimta

Kur ekzaminimi i një mostre të përbashkët prodhon një rezultat pozitiv ose të pasigurt, nga çdo derr merret një mostër tjetër prej 20 g, siç përcaktohet në pikën 4.2 të ISO 18743:2015 (shih, gjithashtu, shtojcat A dhe B të tij për detaje të mëtejshme). Mostrat prej 20g të marra nga pesë derra grumbullohen dhe ekzaminohen duke përdorur metodën e përshkruar në këtë kapitull. Në këtë mënyrë do të ekzaminohen mostrat nga 20 grupe me pesë derra. Kur trikinela zbulohet në një mostër të bashkuar nga pesë derra, mostrat e tjera prej 20 g mbledhen nga derrat individualë të grupit dhe secili ekzaminohet veçmas duke përdorur metodën e përshkruar në këtë kapitull. Mostrat e parazitëve duhet të mbahen në alkool etilik 70–90% (përqendrimi përfundimtar) për t'u ruajtur dhe identifikuar në nivel llojesh në ISUV. Për procedurën e dekontaminimit, shihni pikën 12 të ISO 18743:2015.

B. Metoda e tretjes së mostrave të bashkuara mekanikisht/teknika e “izolimit në filtër”

1. Pajisje dhe reagentë

Siç është përcaktuar në seksionin A(1). Pajisje shtesë:

a) Hinkë 1 litërshe Gelman, e kompletuar me mbajtëse filtri (diametri 45 mm);
b) Disqe filtri, të përbërë nga një rrjetë rrethore prej çeliku inox me një hapje prej 35 mikronësh (diametri i diskut: 45 mm), dy unaza gome 1 mm të trasha (diametri i jashtëm: 45 mm; diametri i brendshëm: 38 mm), rrjeta rrethore vendoset midis dy unazave të gomës dhe lidhet me to, duke përdorur një ngjitës me dy përbërës të përshtatshëm për të dy materialet;

c) Një balonë erlenmajer me kapacitet 3 litra, e pajisur me tub anësor për thithje;

ç) Një pompë filtri;

d) Qese plastike me kapacitet të paktën 80 ml;

dh) Pajisje për vulosjen e qeseve plastike;

e) Renilaza, me fuqi 1:150 000 njësi Sokslet për gram.

2. Mbledhja e mostrave

Siç përcaktohet në pikën 4.2 të ISO 18743:2015 (shih, gjithashtu, shtojcat A dhe B të tij për detaje të mëtejshme).

3. Procedura

I. Grirja

Grirja e mostrave të mishit paraprakisht në një grirëse mishi do të përmirësojë cilësinë e tretjes. Nëse përdoret një blender elektrik, blenderi duhet të vihet në punë tre deri në katër herë për afërsisht për një sekondë për çdo herë.

II. Procedura e tretjes

Kjo procedurë mund të përfshijë bashkimin e plotë (100 g mostra në të njëjtën kohë) ose bashkimet më pak se 100 g.

a) bashkimet e plota (100 mostra në të njëjtën kohë) shih seksionin (3)(II)(a);

b) bashkimet më të vogla (më pak se 100 mostra) shih seksionin A(3)(II)(b).

III. Zbulimi i larvave me filtrim

a) Akulli (300 deri në 400 g copa akulli, akull i shtypur ose akull i grimcuar) shtohet në lëngun e tretjes për të rritur vëllimin e tij në rreth 2 litra. Në rastin e bashkimeve më të vogla, sasia e akullit duhet të reduktohet në mënyrë korresponduese.

b) Lëngu tretës përziehet deri sa të shkrihet akulli. Lëngu tretës i ftohur lihet të paktën për 3 minuta në mënyrë që larvat të rrotullohen në vetvete.

c) Hinka Gelman, e pajisur me mbajtëse filtri dhe disk filtri, montohet në balonën Erlenmajer të lidhur me pompë filtri.

ç) Lëngu i tretjes derdhet në gypin Gelman dhe filtrohet. Në fund të filtrimit, lëngu tretës mund të ndihmohet të kalojë përmes filtrit duke aplikuar thithje me pompën e filtrit. Thithja duhet të ndërpritet përpara se filtri të thahet, d.m.th. kur kanë mbetur në 2 deri në 5 ml lëng hinkë.

d) Kur i gjithë lëngu tretës është filtruar, disku i filtrit hiqet dhe vendoset në një qese plastike me kapacitet 80 ml së bashku me 15–20 ml tretësirë renilazë. Tretësira e renilazës përgatitet duke shtuar 2 gr renilazë në 100 ml ujë rubineti.

dh) Qesja plastike vuloset dy herë dhe vendoset ndërmjet qeses së brendshme dhe të jashtme në *Stomacher*.

e) *Stomacher* lejohet të tundet për 3 minuta, p.sh. kur po punon me një bashkim të plotë ose jo.

ë) Pas 3 minutash, qesja plastike së bashku me diskun e filtrit dhe tretësirën e renilazës hiqet nga *Stomacher* dhe hapet me gërshërë. Lëngu që përmban hidhet në pjatën Petri ose në një pajisje ekuivalente për numërimin e larvave. Qesja lahet me 5–10 ml ujë, i cili pastaj shtohet në pjatën Petri ose në pajisjen ekuivalente për numërimin e larvave dhe ekzaminohet në trikinoskop ose me stereo-mikroskop.

f) Lëngjet tretëse duhet të ekzaminohen sapo të jenë gati. Në asnjë rrethanë ekzaminimi nuk duhet të vonohet deri ditën tjetër.

Shënim. Disqet e filtrave të mos përdoren asnjëherë pa u pastruar plotësisht. Disqet e papastra nuk duhet të lejohen asnjëherë të thahen. Disqet e filtrave mund të pastrohen duke i lënë gjithë natën në tretësirë renilaze. Përpara përdorimit ato duhet të lahen me tretësirë renilaze të freskët, duke përdorur *Stomaicher*-in.

IV. Rezultatet pozitive ose të dyshimta

Siç parashikohet në pikën IV të seksionit A(3).

C. Metoda e tretjes automatike për mostrat e bashkuara deri në 35 gr

1. *Pajisje dhe reagentë*

a) Thikë ose gërshërë për prerjen e kampionëve.

b) Tabaka e ndarë në 50 kuadrate, ku secila prej tyre mund të mbajnë mostrat afërsisht prej 2gr mish, apo mjete të tjera, që japin garanci ekuivalente në lidhje me gjurmueshmërinë e mostrave.

c) Një blender Trichomatic 35®, i pajisur me filtër.

ç) Acid klorhidrik 8,5 ± 0,5 % peshë.

d) Filtra transparente me membranë polikarbonate me diametër 50 mm dhe me madhësi poresh 14 mikronë.

dh) Pepsina me fuqinë e mëposhtme:

- nëse është pluhur ose e grimcuar: 1:10 000 NF (Formulari Kombëtar i SHBA) që korrespondon me 1:12 500 BP (Farmakopeja Britanike) dhe me 2 000 FIP (Federata Internazionale e Farmacisë), ose

- nëse është e lëngshme: pepsinë e lëngshme e stabilizuar me minimumi 660 njësi të Farmakopesë Evropiane/ml.

Aktivitete të tjera të pepsinës mund të përdoren, me kusht që aktiviteti përfundimtar në lëngun tretës të jetë i barabartë me aktivitetin e 10 g prej 1:10 000 NF, siç përcaktohet në pikën 5.3 të ISO 18743:2015.

- e) Shkallën e kalibruar, për peshimin e mostrave dhe/ose pepsinës (saktësia $\pm 0,1$ g).
- ë) Pincetë me majë të sheshtë.
- f) Disa pjata mikroskopi me gjatësi të paktën 5 cm si dhe disa pjata petri me diametër të paktën 6 cm, të shënuara në anën e poshtme me hapësira $10 \times 10 \text{ mm}^2$, duke përdorur një instrument me majë.
- g) Stereo-mikroskop me dritë të transmetuar (me zmadhim 15–60 herë) ose trikinoskop me tavolinë horizontale.
- gj) Enë për hedhjen e mbetjeve të lëngshme.
- h) Enë 10 litërshe që përdoren për dekontaminimin e aparatit, p.sh. me formol, si dhe për lëngjet tretëse që mbesin kur mostrat dalin pozitiv.
- i) Termometër me saktësi 0.5°C , brenda intervalit 20 deri në 70°C .

2. Mbledhja e mostrave

Siç përcaktohet në pikën 4.2 të ISO 18743:2015 (shih, gjithashtu, shtojcat A dhe B të tij për detaje të mëtejshme).

3. Procedura

I. Procedura e tretjes

- a) Vendoset blenderi me filtrin e shtuar, lidhet tubi i mbetjeve dhe tubi vendoset në mënyrë të tillë që të rrjedhë në enën e mbeturinave.
- b) Kur blenderi është i ndezur, do të nisi nxehja.
- c) Përpara se kjo të bëhet, valvola në pjesën e poshtme e vendosur poshtë dhomës së reaksionit duhet të hapet dhe të mbyllet.
- ç) Shtohen deri në 35 mostra që peshojnë afërsisht 1gr secila (në $25\text{--}30^\circ\text{C}$) të marra nga çdo mostër individuale në përputhje me pikën 2. Të sigurohet që pjesët më të mëdha të tendinave janë hequr pasi ato mund të bllokojnë filtrin.
- d) Hidhet ujë deri në skajin e një dhome lëngjesh të lidhur me blenderin (afërsisht 400 ml).
- dh) Shtohen rreth 30 ml acid klorhidrik (8.5%) në skajin e dhomës me të vogël, e lidhur me dhomën e lëngjeve.
- e) Vendoset një membrane filtri nën filtrin e trashë në mbajtësen e filtrit në shtimin e filtrit.
- ë) Në fund, shtohen 7 gr pepsin ose 21 ml pepsin e lëngshme. Kjo radhë duhet të ndiqet rreptësisht për të shmangur dekompozimin e pepsinës.
- f) Mbyllen kapakët e dhomave të reaksionit dhe dhomave të lëngjeve.
- g) Zgjidhet periudha e tretjes. Duhet të caktohet një periudhë e shkurtër tretjeje (5 minuta) për derrat në moshën normale të therjes dhe një kohë më e gjatë (8 minuta) për mostrat e tjera.
- gj) Kur ndizet butoni i fillimit të punës së blenderit, procesi i shpërndarjes dhe i tretjes fillon automatikisht, i ndjekur nga filtrimi. Pas 10–13 minutash procesi përfundon dhe ndalon automatikisht.
- h) Hapni kapakun e dhomës së reaksioneve pasi siguroheni që dhoma është bosh. Në qoftë se ka shkumë ose ka mbetur lëng tretës në dhomë procedura përsëritet në përputhje me seksionin V.

II. Rigjenerimi i larvave

- a) Hiqet mbajtësja e filtrit dhe transferohet membrana filtruese në një mbajtëse të pjerrët ose pjatë petri.
- b) Shqyrtohet membrana filtruese e përdorur në një stereo-mikroskop ose një trikinoskop.

III. Pajisjet e pastrimit

- a) Kur rezultati del pozitiv, dhoma e reaksionit të blenderit mbushet me ujë të valuar deri në $2/3$ e saj. Pastaj hidhet ujë i zakonshëm rubineti në dhomën e lidhur të lëngjeve derisa të mbulohet sensori më i poshtëm. Më pas pastrimi bëhet në mënyrë automatike. Dekontaminimi i mbajtësit të filtrit dhe çdo pajisje tjetër bëhet duke përdorur p.sh. formol.

b) Pasi të përfundojë puna për ditën, mbushni dhomën e lëngut të blenderit me ujë dhe vendoseni në një cikël standard.

IV. Përdorimi i membranës filtruese

Çdo filtër me membranë polikarbonate mund të përdoret jo më shumë se pesë herë. Filtër duhet të rrotullohet ndërmjet çdo përdorimi. Përveç kësaj, filtër duhet të kontrollohet pas çdo përdorimi për ndonjë dëmtim që do ta bënte atë të papërshtatshëm për përdorim të mëtejshëm.

V. Metoda që përdoret kur tretja nuk është e plotë dhe nuk mund të bëhet filtrimi.

Pasi blenderi vendoset në ciklin automatik sipas seksionit I, hapet kapaku i dhomës së reaksionit dhe kontrollohet nëse ka shkumë ose lëng tjetër të mbetur në dhomë. Në qoftë se ka të tilla, veprohet si më poshtë:

- a) mbyllet valvola e poshtme poshtë dhomës së reaksionit;
- b) largohet mbajtësja e filtrit dhe transferohet membrana filtruese në një pjatë mikroskopi ose pjatë petri.
- c) vendoset një membranë e re filtruese te mbajtësi i filtrit dhe montohet mbajtësja e filtrit;
- ç) mbushet dhoma e lëngjeve të blenderit me ujë derisa sensori i poshtëm të mbulohet;
- d) kryhet cikli automatik i pastrimit;
- dh) pasi cikli i pastrimit ka mbaruar, hapet kapaku i dhomës së reaksionit dhe kontrollohet për mbetje lëngjesh;
- e) kur dhoma është bosh, hiqet mbajtësja e filtrit dhe vendoset membrana e filtrit te një pjatë mikroskopi ose pjatë petri me anë të pincetës;
- ë) ekzaminohen dy membranat e filtrave në përputhje me seksionin II; në qoftë se filtrat nuk mund të ekzaminohen, përsëritet i gjithë procesi i tretjes me kohë tretje më të gjatë në përputhje me seksionin I.

VI. Rezultatet pozitive ose të dyshimta

Siç parashikohet në pikën IV të seksionit A(3).

D. Metoda me përzierie magnetike për tretjen e mostrave të bashkuara/“izolimi në filtër” dhe zbulimi i larvave me testin e aglutinimit latex

Kjo metodë konsiderohet e barasvlershme vetëm për testimin e mishit të derrave shtëpiake.

1. Pajisje dhe reagentë

- a) Thikë ose gërshërë dhe pinceta për prerjen e mostrave.
- b) Tabaka e ndarë në 50 kuadrate, ku secila prej tyre mund të mbajë mostrat afërsisht prej 2 gr mish apo mjete të tjera, duke dhënë garanci ekuivalente, në lidhje me gjurmueshmërinë e mostrave.
- c) Blender me teh të mprehtë prerës. Kur mostrat janë më të mëdha se 3 gr, përdoret një grirësë mishi me hapje 2–4 mm ose gërshërë. Në rastin e mishit të ngrirë apo gjuhës (pas largimit të shtresës sipërfaqësore, e cila nuk mund të tretet) nevojitet përdorimi i grirësit të mishit dhe madhësia e mostrave rritet në mënyrë të konsiderueshme.
- ç) Përzierës magnetik me pjatë ngrohje të kontrolluar në mënyrë termostatike dhe thupër për përzierje të veshur me Teflon afërsisht 5 cm i gjatë.
- d) Bejkera qelqi, kapaciteti 3 litra.
- dh) Sita, madhësia e rrjetës 180 mikron, diametri i jashtëm 11 cm, me rrjetë inoksi.
- e) Aparat filtrimi prej çeliku për rrjeta filtri 20 µm me hinkë çeliku.
- ë) Pompë vakumi.
- f) Enë (depozita) metali ose plastike, me kapacitete 10–15 litra, për të mbledhur lëngun tretës.
- g) Një rrotullues 3D.
- gj) Fletë alumini.
- h) Acid klorhidrik 25%.
- i) Pepsina me fuqinë e mëposhtme:

- nëse është pluhur ose e grimcuar: 1:10 000 NF (Formulari Kombëtar i SHBA) që korrespondon me 1:12 500 BP (Farmakopeja Britanike) dhe me 2 000 FIP (Federata Internazionale e Farmacisë), ose

- nëse është e lëngshme: pepsinë e lëngshme e stabilizuar me minimumi 660 njësi të Farmakopesë Evropiane/ml.

Aktivitete të tjera të pepsinës mund të përdoren, me kusht që aktiviteti përfundimtar në lëngun tretës të jetë i barabartë me aktivitetin e 10 g prej 1:10 000 NF, siç përcaktohet në pikën 5.3 të ISO 18743:2015.

j) Ujë rubineti i nxehtë në 46–48°C.

k) Peshore e kalibruar, për peshimin e mostrave dhe/ose pepsinës (saktësia $\pm 0,1$ g).

l) Pipeta të madhësive të ndryshme (1, 10 dhe 25 ml), mikropipeta sipas instruksioneve të prodhuesit të aglutinit të lateksit si dhe mbajtëse pipetash.

ll) Filtra me rrjetë najloni 20 mikronë me diametër që përputhet me sistemin e filtrimit.

m) Pinceta plastike ose çeliku nga 10–15 cm.

n) Shishe konike, 15 ml.

nj) Shtypës havani me majë konike tefloni ose çeliku për t'u futur në shishe konike.

o) Termometër me saktësi 0.5°C, brenda intervalit 20–70°C.

p) Letra aglutinuuese lateksi të testit me kit Trichin-L Antigen të validuar me kodin nr. EURLP_D_001/2011.

q) Tretësirë asnjane (buffer) me konservantë (hollues kampioni) për testin me kit Trichin-L i validuar me kodin Nr EURLP_D_001/2011.

r) Tretësirë asnjane (buffer) të shtuar me konservantë (kontrolli negativ) të testit me kit Trichin-L antigen i validuar me kodin Nr EURLP_D_001/2011.

rr) Tretësirë asnjane (buffer) të shtuar me antigenet e *Trichinella spiralis* dhe konservantë (kontrolli pozitiv) i testit me kit Trichin-L antigen i validuar me kodin nr. EURLP_D_001/2011.

s) Tretësirë asnjane (buffer) të veshur me copëza polistireni të shtuar me antitropa me konservantë (rruaza lateksi) të testit me kit me antigen të Trichin-L validuar me kodin nr. EURLP_D_001/2011.

sh) Kunja njëpërdorimësh.

2. Mbledhja e mostrave

Siç përcaktohet në pikën 4.2 të ISO 18743:2015 (shih, gjithashtu, anekset A dhe B të tij për detaje të mëtejshme).

3. Procedura

I. Për bashkime të plota (100 g mostra në të njëjtën kohë)

a) $16 \pm 0,5$ ml acid kloridrik 25 % (0,2 % finale) hidhet në një bejker 3 litra që përmban 2.0 litra ± 200 ml ujë rubineti, të ngrohur paraprakisht në 46–48°C; thupra përzierëse vendoset në bejker dhe bejkeri vendoset në pjatën e parangrohur dhe fillon përzierja.

b) Shtohet 10 ± 1 gr pepsinë pluhur (ose 30 ± 3 ml pepsin e lëngshme).

c) 100–115 g mostra të mbledhura në përputhje me pikën 2 copëtohen në blender bashkë me 150 ± 15 ml tretësirë asnjane (buffer) të ngrohur më parë.

ç) Mishi i copëtuar transferohet në një bejker 3 litra që përmban ujë, pepsin dhe acid klorhidrik.

d) Thika e blenderit zhytet herë pas here në lëngun tretës në bejker dhe ena e blenderit shpëlahet me sasi të vogla të lëngut tretës për të larguar çdo sasi mishi që mund të jetë ngjitur.

dh) Bejkeri mbulohet me fletë alumini.

e) Përzierësi magnetik duhet të rregullohet në mënyrë të tillë që të mbajë një temperaturë konstante 4–46°C gjatë gjithë veprimt. Gjatë përzierjes, lëngu tretës duhet të rrotullohet me shpejtësi të lartë të mjaftueshme për të krijuar një fugë të thellë por pa spërkatur.

ë) Lëngu tretës përzihet derisa grimcat e mishit zhduken (afërsisht 30 minuta). Më pas, përzierësi fiket dhe lëngu tretës hidhet nëpërmjet sitës në hinkën e sedimentimit. Tretja mund të kërkojë kohë të gjatë (jo më shumë se 60 minuta) në përpunimin e disa llojeve të mishit (gjuhë, mish gjahu etj.).

f) Procesi i tretjes konsiderohet i kënaqshëm në qoftë se jo më shumë se 5% e peshës së mostrës fillestare mbetet në sitë.

g) Filtri me rrjetë najloni 20 mikronë vendoset në mbajtësen e filtrit. Hinka konike prej çeliku filtruese fiksohet te mbajtësja me sistem bllokimi dhe rrjeta prej çeliku me madhësi 180 mikronë vendoset në hinkë. Pompa e vakumit lidhet me mbështetësen e filtrit dhe me enën prej metali apo plastike, për të mbledhur lëngun tretës.

gj) Përzierja ndalohet dhe lëngu tretës hidhet në hinkën e filtrimit nëpërmjet rrjetës. Bejkeri shpëlahet afërsisht me 250 ml ujë të ngrohtë. Uji i shpëlarjes hidhet në filtrues pasi të jetë filtruar plotësisht lëngu tretës.

h) Membrana e filtrimit kapet me pincetë, duke e mbajtur nga anët. Kjo membranë paloset në katërsh (minimumi) dhe futet në tubin konik 15 ml. Zgjedhja e tubit konik duhet t'i përshtatet shtypësit të havanit.

i) Membrana e filtrimit shtyhet në fund të tubit konik 15 ml me ndihmën e shtypësit të havanit dhe shtypet fort, duke bërë afërsisht 20 lëvizje të njëpasnjëshme shtypëse lart e poshtë me shtypësin e havanit, i cili duhet të pozicionohet brenda palosjes së membranës filtruese, sipas udhëzimeve të prodhuesit.

j) $0,5 \pm 0,01$ ml nga holluesi i mostrës shtohet në tubin konik 15 ml me pipetë dhe membrana filtruese homogjenizohet me shtypësin e havanit duke bërë lëvizje të njëpasnjëshme me amplitudë të ulët lart e poshtë për 30 sekonda, duke shmangur lëvizjet e papritura për të kufizuar spërkatjen, sipas udhëzimeve të prodhuesit.

k) Çdo mostër, kontrolli negativ dhe kontrolli pozitiv shpërndahen me pipeta në fusha të ndryshme të letrës së aglutinimit, sipas udhëzimeve të prodhuesit.

l) Rruazat e lateksit shtohen me pipetë në çdo fushë të letrës së aglutinimit, sipas udhëzimeve të prodhuesit, pa i venë ato në kontakt me mostrën/mostrat dhe me kontrollet. Në çdo fushë, rruazat e lateksit përzihen me kujdes me një thupër të përshtatshme deri sa lëngu i homogjenizuar të mbulojë të gjithë fushën.

ll) Letra aglutinuese vendoset në tundësin 3D dhe tundet për 10 ± 1 minuta, sipas udhëzimeve të prodhuesit.

m) Pas kohës së përcaktuar nga udhëzimet e prodhuesit, tundja ndalohet dhe letra e aglutinimit vendoset në një sipërfaqe të sheshtë dhe rezultatet e reaksionit lexohen menjëherë, sipas udhëzimeve të prodhuesit. Agregatat e rruazave shfaqen në rastet kur kemi një mostër pozitive. Në rast të mostrave negative, gjendja e turbullt mbetet homogjene, pa aggregate të rruazave.

II. Për bashkime më të vogla se 100 gr, siç përcaktohet në pikën 8 të ISO 18743:2015.

Aty ku nevojitet, mund të shtohen deri në 15 g në një bashkim total prej 100 g dhe të ekzaminohen së bashku me këto mostra në përputhje me seksionin I. Më shumë se 15 g duhet të ekzaminohen si një bashkim i plotë. Për bashkime deri në 50 g, lëngu tretës dhe përbërësit mund të reduktohen në 1 litër ujë, 8 ml acid klorhidrik dhe 5 g pepsinë.

III. Rezultatet pozitive ose të dyshimta

Kur ekzaminimi i një mostre kolektive jep rezultat pozitiv ose të dyshimtë në testin e aglutinimit të lateksit, një mostër tjetër prej 20 g merret nga çdo derr në përputhje me pikën 4.2 të ISO 18743:2015 (shih, gjithashtu, anekset A dhe B të tij për detaje të mëtejshme). Mostrat prej 20 gr nga pesë derra bashkohen dhe ekzaminohen duke përdorur metodën e përshkruar në seksionin I. Në këtë mënyrë mund të ekzaminohen mostrat nga 20 grupe me pesë derra.

Kur merret një rezultat pozitiv nga aglutinimi i lateksit nga një grup prej pesë derrash, 20 gr mostra të tjera merren nga individët në grup dhe secili ekzaminohet veçmas, duke përdorur metodën e përshkruar në seksionin I.

Kur merret një rezultat pozitiv ose i dyshimtë nga aglutinimi i lateksit, të paktën 20 gr nga muskujt e derrit dërgohet në laboratorin kombëtar të referencës (ISUV) për konfirmim, duke përdorur ISO 18743:2015 ose një nga metodat ekuivalente siç përshkruhet më sipër.

Mostrat e parazitëve duhet të mbahen në alkool etilik 70–90 % (përqendrimi përfundimtar) për t'u ruajtur dhe identifikuar në nivel llojesh në laboratorin kombëtar të referencës (ISUV).

Pas mbledhjes së parazitëve, lëngjet pozitive duhet të dekontaminohen duke u ngrohur me nxehtësi të pakën deri në 60°C.

IV. Procedura e pastrimit dhe dekontaminimit pas rezultateve pozitive apo të dyshimta

Kur nga ekzaminimi i një mostre kolektive apo individuale në testin e aglutinimit të lateksit, dalin rezultate pozitive ose të dyshimta, i gjithë materiali në kontakt me mishin (tasi dhe tehu i blenderit, thika, shtypësi i havanit, bejkeri, thupra përzierëse, sensori i temperaturës, hinka konike e filtrimit, sita dhe pincetat) duhet të dekontaminohen me kujdes, duke i zhytur për disa sekonda në ujë të nxehtë (65 - 90°C). Mbetjet e mishit ose larvat e pa aktivizuara që mund të mbesin në sipërfaqen e tyre duhet të largohen me sfungjer të pastër dhe me ujë rubineti. Nëse është e nevojshme, disa pika detergjent mund të shtohen për të larguar yndyrën nga pajisjet. Më pas rekomandohet shpëlarja e çdo pjese plotësisht për të hequr të gjitha gjurmët e detergjentit.

E. Testi i tretjes artificiale për zbulimin *in vitro* të larvave të *Trichinella spp.* në mostrat e mishit PrioCHECK® *Trichinella* AAD Kit.

Kjo metodë është konsideruar e barasvlershme vetëm për testimin e mishit të derrave shtëpiake.

Ky test me kit PrioCHECK® *Trichinella* AAD Kit duhet të përdoret sipas manualit të udhëzimeve të manualit duke përdorur hinka të ndara (Lenz NS 29/32) dhe tub testi qelqi prej 80 ml.

SHTOJCA II TRAJTIMET ME NGRIRJE

A. Metoda e ngrirjes 1

- a) Mishi i sjellë në gjendje të ngrirë duhet të ruhet në këtë gjendje.
- b) Pajisjet teknike, si dhe furnizimi me energji i dhomës frigoriferike duhet të jenë të tilla që të sigurojnë që temperatura e kërkuar të arrihet shpejt dhe të mbahet në të gjitha pjesët e dhomës dhe të mishit.
- c) Paketimet e izoluara hiqen përpara ngrirjes, me përjashtim të rasteve kur mishi është në temperaturën e kërkuar në momentin që është sjellë në dhomën frigoriferike, si dhe në rastet kur mishi është paketuar në mënyrë të tillë që nuk e pengon mishin të arrijë temperaturën e kërkuar brenda kohës së duhur.
- ç) Ngarkesat në dhomën frigoriferike duhet të mbahen të ndara veç dhe të mbyllura me çelës.
- d) Regjistrohet koha dhe data kur secila ngarkesë futet në dhomën frigoriferike.
- dh) Temperatura në dhomën frigoriferike duhet të jetë të paktën -25°C. Kjo temperaturë matet, duke përdorur instrumente të kalibruara termoelektrike dhe regjistrohet vazhdimisht. Temperatura nuk duhet të matet direkt në rrymën e ajrit të ftohtë. Instrumentet duhet të mbahen të mbyllura me çelës. Grafikët e temperaturës duhet të mbajnë të dhënat përkatëse nga registri i inspektimit të mishit të importit, si dhe datën dhe kohën e fillimit dhe përfundimit të ngrirjes së mishit. Këto të dhëna të ruhen për 1 vit pas plotësimit.
- e) Mishi me diametër ose trashësi deri në 25 cm duhet të ngrihet për të paktën 240 orë pa ndërprerje, ndërsa mishi me diametër ose trashësi nga 25 cm deri në 50 cm duhet ngrihet për të

paktën 480 orë pa ndërprerje. Ky proces ngrirjeje nuk duhet të aplikohet për mishin me trashësi ose diametër më të madh. Koha e ngrirjes llogaritet duke u nisur nga pika kur temperatura në dhomën e ngrirjes arrin atë të specifikuar në germën “P”.

B. Metoda e ngrirjes 2

Dispozitat e përgjithshme dhënë në germat “a” deri “e” të seksionit A (metoda 1) zbatohen edhe në këtë rast dhe kombinimi kohë-temperaturë aplikohet si më poshtë:

a) mishi me diametër ose trashësi deri në 15 cm duhet të ngrihet sipas një nga kombinimet kohë-temperaturë të mëposhtme:

- 20 ditë në -15°C;
- 10 ditë në -23°C;
- 6 ditë në -29°C.

b) mishi me diametër ose trashësi ndërmjet 15 cm dhe 50 cm duhet të ngrihet sipas një nga kombinimet kohë-temperaturë të mëposhtme:

- 30 ditë në -15°C;
- 20 ditë në -25°C;
- 12 ditë në -29°C.

Temperatura në dhomën e ngrirjes nuk duhet të jetë më e madhe se niveli i temperaturës së inaktivimit të zgjedhur. Kjo temperaturë matet duke përdorur instrumente të kalibruara termoelektrike dhe regjistrohet vazhdimisht. Temperatura nuk duhet të matet direkt në rrymën e ajrit të ftohtë. Instrumentet duhet të mbahen të mbyllura me çelës. Grafikët e temperaturës duhet të mbajnë të dhëna nga regjistri i inspektimit të mishit të importit si dhe datën dhe kohën e fillimit dhe përfundimit të ngrirjes së mishit. Këto të dhëna të ruhen për 1 vit pas plotësimit.

Kur përdoren tunelet e ngrirjes dhe procedurat e përshkruara në seksionet A dhe B nuk ndiqen në mënyrë rigorozë, operatori i biznesit ushqimor duhet të jetë në gjendje t'i provojë autoritetit kompetent se metoda alternative është efektive në vrasjen e parazitëve trkinela në mishin e derit.

C. Metoda e ngrirjes 3

Trajtimi konsiston në tharjen me ngrirje ose ngrirjen komerciale të mishit për kombinime të specifikuara kohë-temperaturë me temperaturë të monitoruar në qendër të secilës copë.

a) Dispozitat e përgjithshme dhënë në germat “a” deri “e” të seksionit A (metoda 1) zbatohen edhe në këtë rast dhe aplikohet kombinimi kohë-temperaturë, si më poshtë:

- 106 orë në -18°C;
- 82 orë në -21°C;
- 63 orë në -23,5°C;
- 48 orë në -26°C;
- 35 orë në -29°C;
- 22 orë në -32°C;
- 8 orë në -35°C;
- 1/2 orë në -37°C.

b) Temperatura matet duke përdorur instrumente termoelektrike të kalibruara dhe regjistrohet vazhdimisht. Termometri futet në qendër të copës së prerë të mishit e cila nuk duhet të jetë më e vogël se pjesa më trashë e mishit që duhet të futet në ngrirje. Kjo copë futet në dhomën e ngrirjes në pozicionin më pak të favorshëm, jo ngjitur me pajisjet e ftohjes apo direkt në rrymën e ftohtë të ajrit. Instrumentet duhet të mbahen të mbyllura me çelës. Grafikët e temperaturës duhet të mbajnë të dhëna nga regjistri i inspektimit të mishit të importit, si dhe datën dhe kohën e fillimit dhe përfundimit të ngrirjes së mishit. Këto të dhëna të ruhen për 1 vit pas plotësimit.

EKZAMINIMI I KAFSHËVE TË TJERA NGA DERRI

Mishi i njëthunrakëve, mishi i kafshëve të gjahut dhe çdo mish tjetër që mund të përmbajnë parazitët trikinela duhet të ekzaminohet në përputhje me një nga metodat e tretjes të përcaktuara në kapitullin I ose II, të shtojcës I, me ndryshimet e mëposhtme:

a) mostra me peshë të paktën 10 gr merren nga gjuha ose muskujt e nofullës së njëthundrakëve dhe nga këmbët e përparme, gjuha ose diafragma e derrit të egër;

b) në rastin e njëthundrakëve, ku këto muskuj mungojnë, një mostër me madhësi më të madhe merret nga një këmbë e diafragmës në kalimin për në pjesën e forcuar. Muskujt duhet të pastrohen nga indet lidhëse dhe yndyra;

c) të paktën 5 gr mostër tretet duke ndjekur metodën referencë të zbulimit të përcaktuar në kapitullin I ose një metodë ekuivalente të përcaktuar në kapitullin II. Për çdo tretje, pesha totale e muskujve të ekzaminuar nuk duhet të kalojë 100 gr në rastin e metodës së përcaktuar në kapitullin I dhe metodat A dhe B të përcaktuara në kapitullin II si dhe 35 gr në rastin e metodës C të përcaktuar në kapitullin II;

ç) kur rezultati është pozitiv, merret një mostër tjetër 50 gr për një ekzaminim të mëvonshëm të pavarur;

d) pa cenuar rregullat për ruajtjen e specieve të kafshëve, i gjithë mishi të kafshëve të gjahut, përveç derrit të egër, të tilla si: arinj, gjitarët mishngrënës (përfshirë gjitarët e detit) dhe zvarranikët testohen duke marrë mostra 10 gr të muskujve në vendet e preferuara ose sasi më të mëdha në qoftë se këto vende nuk janë të disponueshme. Vendet e preferuara janë:

i. tek arinjtë: diafragma, muskuli maseter dhe gjuha;

ii. te lopët e detit: gjuha;

iii. te krokodilët: muskujt maseter, pterygoid dhe ndërbrinjorë;

iv. te zogjtë: muskujt e kokës (p.sh. muskujt maseter dhe muskujt e qafës);

dh) koha e tretjes duhet të jetë e mjaftueshme për të siguruar tretjen e duhur të indeve të këtyre kafshëve, por nuk duhet të kalojë 60 minuta.

SHTOJCA IV

KAPITULLI I

NJOHJA ZYRTARE E FERMAVE OSE E NJË KOMPARTAMENTI QË APLIKON KUSHTE STREHIMI TË KONTROLLUARA

A. Operatorët e biznesit ushqimor për të marrë njohjen zyrtare të fermave duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

a) operatori duhet të ketë marrë të gjitha masat paraprake praktike në lidhje me ndërtimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave në mënyrë që të parandalojë që brejtësit, çdo lloj gjitari tjetër dhe shpendët mishngrënës të kenë akses në ndërtesat ku mbahen kafshët;

b) Operatori duhet të zbatojë një program efektiv për kontrollin e insekteve, veçanërisht për brejtësit, në mënyrë për të parandaluar infestimin e derrave. Operatori duhet të mbajë të dhëna të programit sipas kërkesës së AKVMB-së;

c) Operatori duhet të sigurojë që i gjithë ushqimi për kafshë të jetë marrë nga një fabrikë që prodhon ushqime për kafshë;

ç) Operatori duhet të ruajë ushqimin për kafshë të destinuar për speciet e prekshme nga trikinela në kapanone të mbyllura ose kontejnerë të tjerë që janë të padepërtueshëm nga brejtësit. Të gjitha

furnizimet e tjera me ushqim për kafshë duhet të trajtohen me nxehtësi ose të prodhohen dhe të ruhen sipas kërkesave të AKVMB-së;

d) Operatori duhet të sigurojë që kafshët e ngordhura të mblidhen, identifikohen dhe transportohen pa vonesa të panevojshme në përputhje me legjislacionin për nënproduktet me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor;

dh) Nëse një vendgrumbullim mbeturinash ndodhet në afërsi të fermës, operatori duhet të informojë AKVMB-në. Më pas, AKVMB-ja duhet të vlerësojë risqet e përfshira dhe të vendosë nëse ferma do të njihet si një fermë që zbaton kushte strehimi të kontrolluara;

e) Operatori duhet të sigurojë identifikimin e derrave shtëpiakë, në mënyrë që çdo kafshë në fermë të mund të gjurmohet;

ë) operatori duhet të sigurojë që derrat shtëpiakë do të futen në fermë vetëm nëse ata origjinojnë dhe vijnë nga ferma që njihen zyrtarisht se zbatojnë kushte strehimi të kontrolluara;

f) Asnjë nga derrat shtëpiakë nuk duhet të ketë akses në ambientet e jashtme, përveç rasteve kur operatori për të plotësuar kërkesat e AKVMB-së, mund të tregojë me anë të një analize risku se periudha kohore, objektet dhe rrethanat e daljes në natyrë nuk paraqesin rrezik për futjen e trikinelës në fermë.

B. Operatorët e biznesit ushqimor të fermave të njohura zyrtarisht se zbatojnë kushte strehimi të kontrolluara duhet të informojnë AKVMB-në kur ndonjë nga kërkesat e përcaktuara në germën A nuk arrin të përmbushet më ose kur ka ndodhur ndonjë ndryshim tjetër që mund të ndikojë në statusin e fermës.

C. AKVMB-ja mund të njohë një fermë ose një kategori fermash vetëm me kusht që të ketë verifikuar se kërkesat e përcaktuara në germën A, janë përmbushur.

KAPITULLI II

RAPORTIM MBI SITUATËN E TRIKINELËS

Numri i testeve dhe rezultatet e testimit për trikinelën në derrat shtëpiakë, derrat e egër, njëthundrakët, kafshët e gjahut dhe çdo kafshë tjetër e prekshme nga trikinela, do të dorëzohen në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Të dhënat për derrat shtëpiakë duhet të paktën të ofrojnë informacion specifik, në lidhje me:

- i. testet mbi kafshët e rritura në kushte strehimi të kontrolluara;
- ii. teste për dosat e mbarështimit dhe derrat e majmërisë.

SHTOJCA V

VENDET E TRETA OSE RAJONET E TYRE QË ZBATOJNË PËRJASHTIMET E PËRMENDURA NË NENIN 13(2)

Kodi ISO i vendit	Vendi i tretë ose rajonet e tij	Vërejtje
BM	Mbretëria e Bashkuar (*)	Zbatimi i përjashtimeve të parashikuara në nenin 3, pika 2 dhe 3

(*) Në përputhje me Marrëveshjen për tërheqjen e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut nga Bashkimi Evropian dhe Komuniteti Evropian i Energjisë Atomike dhe, në veçanti neni 5(4) i Protokollit për Irlandën/Irlandën e Veriut, në lidhje me shtojcën 2 të këtij Protokollit, për qëllimet e kësaj shtojce, referencat në Mbretërinë e Bashkuar nuk përfshijnë Irlandën e Veriut.